



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’ Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Termet e Referencës

Pozicioni:	Ekspert lokal
Vendodhja:	Shqipëri
Fillimi i Punës:	29.10.2021
Mbarimi i Punës:	30.11.2021
Kohëzgjatja:	20 ditë punë

Projekti

Ditët e sotme burgjet janë mjedise multi-etnike. Diversiteti etnik dhe kulturor i të burgosurve paraqet sfida të shumëfishta për stafin e vijës së parë në burgje, të cilët përballen më kultura e gjuhë të “panjohura”, fenomenin e nën-kulturës dhe episode të mundshme radikalizimi dhe ekstremizmi. Menaxhimi i aspekteve multi-kulturore në ambientet e burgjeve është një çështje prioritare në legjislacionin e BE-së, siç theksohet edhe në Rekomandimin Cm/ Rec (2012)12 të Këshillit të Ministrave. Nisur nga kjo ka lindur nevoja që stafi i burgjeve të marrë trajnimet e duhura për tu përballur me nevojat dhe të drejtat e të burgosurve të huaj. Në këtë kuadër, projekti 2 vjeçar “B-ComPetent – Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe” ka për qëllim të kontribuojë në aplikimin koherent dhe efektiv të legjislacionit dhe standardeve të BE lidhur me trajtimin e të burgosurve të huaj nëpërmjet ndërtimit dhe implementimit të një programi të tipit “train-the-trainers” (ballë-për-ballë dhe e-learning), kombinuar me praktikën më të mira, aksione për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjeteve praktike multi-gjuhësore. Avokati i Popullit në bashkëpunim me gjashtë partner, janë duke implementuar projektin nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*” i bashkë financuar nga Programi i Drejtësisë së BE (2014-2020).

Objektivi

Avokati i Popullit kërkon të rekrutojë një Ekspert vendas, i cili do të angazhohet **për organizimin e takimeve në IEVP-të e Thivës dhe Koridhalos në Greqi ku ka shumice shtetasish shqiptarë që vuajnë dënimin dhe hartimin e raportit përkatës**, i cili do të shërbej si raport i vecantë, produkt i MKPT-së dhe raport për projektin e ndihmës huaj nr. 854040 “Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe” si produkt i Avokatit të Popullit.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Avokati i Popullit do të kërkojë kryerjen e shërbimit nga **një Ekspert vendas**, i cili do të jetë **përgjegjës për organizimin e një vizite/aktiviteti në IEVP-të e Greqisë dhe hartimin e një raporti i cili do të ketë në fokus kushtet e trajtimit të të burgosurve shqiptar si të burgosur të huaj në Greqi.**

Kriteret e veçanta

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat juridike, preferohet me master shkencor në shkenca juridike;
- Të ketë eksperiencë të gjatë në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, sidomos të burgosurit e huaj;
- Të ketë njohuri lidhur me objektin e veprimtarisë së seksionit të MKPT-së pranë Avokatit të Popullit;
- Vlerësohet nëse eksperti ka pasur bashkëpunime të tjera të mëparshme me institucionin e Avokatit të Popullit;
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar;
- Preferohet të ketë njohuri të gjuhës greke;
- Të ketë aftësi në draftimin e raporteve të ndryshme dhe procedurave administrative, si dhe aftësi shumë të mira komunikimi;
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial.

Aplikanti duhet të dorëzoj:

1. Letër motivimi
2. Curriculum vitae
3. Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin.

Afati i aplikimit: 27 Tetor 2021

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

Adresa: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D’Ark nr. 2, Tiranë

